

KUJDES!

- Mos harroni të ngjyrosni grupin (A ose B) në fletë-përgjigjen e provimit. **Fletë-përgjigjet me grupin e pakoduar nuk vlerësohen.**
- Çdo pyetje ka vetëm një përgjigje të saktë. Nëse një pyetjeje i jepni dy përgjigje atëherë ajo pyetje do të vlerësohet si e gabuar.
- Përgjigja do të ngjyroset me laps. Në të kundërt kompjuteri nuk do ta lexojë.
- Përgjigjen e pyetjes do ta ngjyrosni vetëm brenda rrethit siç është vepruar në shembullin e poshtëshënuar

Saktë ☐ A ☐ B ☒ C ☐ D

Gabim ☒ A ☐ B ☒ C ☐ D

- Bëni kujdes për të mos dalë jashtë rrethit kur të ngjyrosni përgjigjen.
- Mos bëni asnjë veprim mbi fletë përgjigjen e provimit si shkarravitje, rrudhosje etj.
- Mos iu përgjigjini pyetjeve për të cilat nuk jeni të sigurtë. **Kujdes! 3 përgjigje gabim fshijnë një të saktë.**
- Mos qëndroni shumë tek pyetjet që nuk zgjidhni dot, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tjera.
- Koha e provimit është **150 minuta**. Shfrytëzoni deri në fund kohën e provimit. Në qoftë se ju tepron kohë, bëjini dhe një kontroll testit.
- Përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në këtë libërth, do të kodohen në fletë-përgjigje në pjesën ku shkruan “PERGJIGJET”.
- Në provim **ndalohet** mbajtja ose përdorimi i celularit dhe makinës llogaritëse.
- Rezultati i provimit bazohet vetëm në fletë-përgjigje.
- Libërthi i pyetjeve dorëzohet bashkë me fletë-përgjigjen dhe nuk kërkohet marrja e tij.

Suksese!

1.

$$B = \{a, b, c\} \text{ dhe } C = \{b, c, d\}$$

 Sa është vlera e $n(B \cup C) + n(B \cap C)$?

- A) 4
- B) 5
- C) 6
- D) 7

2.

$$a \cdot k = 120 \text{ dhe } a \cdot t = 80.$$

 Gjej $a \cdot (k - t)$.

- A) 20
- B) 25
- C) 40
- D) 80


3.

Mosha mesatare e një grupi prej tre personash është 30 vjeç. Nëse një nxënës dhjetëvjeçar i bashkohet grupit, sa do të jetë mosha mesatare e grupit të ri?

- A) 15
- B) 20
- C) 25
- D) 27

4.

Në figurë, $AB \perp AD$, $m\angle BAC = 40^\circ$ dhe AE përgjysmon $\angle CAD$. Gjeni $m\angle EAD$.



- A) 15°
- B) 20°
- C) 25°
- D) 30°

5.

Gjej vlerën e $1\frac{1}{2} + \left(\frac{3}{4} - \frac{1}{2}\right)$.

- A) $\frac{1}{4}$
- B) $\frac{1}{2}$
- C) $1\frac{3}{4}$
- D) $1\frac{1}{2}$

6.

Cili veprim duhet në vend të $\square$?

$$2\frac{2}{7} \square \frac{4}{7} = 4$$

- A) $\times$
- B) $\div$
- C) $+$
- D) $-$

7.

$a = 0.2005$, $b = 0.25$ dhe $c = 0.205$.

Cili pohim është i vërtetë?

- A) $a > b > c$
- B) $a > c > b$
- C) $b > a > c$
- D) $b > c > a$

8.

Në një hartë me shkallë zvogëlimi

1 : 1 000 000, dy qytete janë 2 cm larg njëri-tjetrit. Gjeni distancën reale midis dy qyteteve në kilometra.

- A) 2 km
- B) 20 km
- C) 100 km
- D) 200 km

9.

Shumëfishat e 3-shit midis numrave 1 dhe 25 shkruhen në karta të veçanta dhe vendosen në një kuti. Një kartë nxirret nga kutia në mënyrë të rastësishme. Sa është probabiliteti për të nxjerrë një numër çift?

- A) $\frac{1}{6}$
- B) $\frac{1}{4}$
- C) $\frac{1}{3}$
- D) $\frac{1}{2}$

10.

Cili pohim është i vërtetë për numrin dhjetor 3,4285?

- A) Kur rrumbullakoset në dhjetëshen më të afërt, vlera e përafërt e tij është 4.
- B) Kur rrumbullakoset në të qindtën më të afërt, vlera e përafërt e tij është 3,42.
- C) Kur rrumbullakoset në të dhjetën më të afërt, vlera e përafërt e tij është 3,4.
- D) Kur rrumbullakoset në të mijtën më të afërt, vlera e përafërt e tij është 3,428.

11.

75% e nxënësve në një klasë janë djem. Nëse 10 janë vajza, gjeni numrin e djemve në klasë.

- A) 20
- B) 25
- C) 30
- D) 40


12.

40 litra kolonjë hidhen në shishe 250 mililitërshe. Sa shishe nevojiten?

- A) 120
- B) 140
- C) 160
- D) 180

13.

Një mësuese i kërkon nxënësit të saj të vizatojë lartësinë nga brinja BC në trekëndëshin me kënd të gjërë ABC të dhënë më sipër. Cili segment është lartësia?



- A) AF
- B) FB
- C) BD
- D) AE

14.

Gjej $3 - 3 \cdot (4 - 6) =$

- A) -6
- B) 0
- C) 3
- D) 9


15.

Janë dhënë $-3 \cdot a > 0$ dhe $a \cdot b > 0$. Cilat janë shenjat respektive të numrave a dhe b ?

- A) +, +
- B) +, -
- C) -, +
- D) -, -

16.

Në figurë, $EB \parallel CD$, $AC \parallel BD$ dhe $m\angle CDB = 125^\circ$. Gjeni $m\angle EAC$.



- A) 55°
- B) 75°
- C) 85°
- D) 125°

17.

Thjeshtoni shprehjen

$$3 \cdot (2a - 3) + (a - 3) \cdot (a - 3)$$

- A) a^2
- B) $a^2 - 9$
- C) $a^2 - 3a$
- D) $a^2 + 3a$

18.

Tetë më shumë se një numër është e barabartë me trefishin e atij numri.

Cila është diferenca midis pesëfishit të numrit dhe vetë numrit?

- A) 16
- B) 18
- C) 20
- D) 24

19.

Ani bën 1.6 km për 16 minuta me një shpejtësi mesatare.

Sa minuta do t'i duhen për të përshkuar 2.5 km me të njëjtën shpejtësi?


- A) 18
- B) 20
- C) 24
- D) 25

20.

Në figurë, **ABC** është një trekëndësh me

AB = AC dhe **m∠BAC = 40°**.

Gjeni **m∠ACD**.



- A) 110
- B) 115
- C) 120
- D) 125

21.

Cila është më e madhe për këtë grup numrash?

20, 21, 22, 23, 23, 50

- A) Moda
- B) Amplituda
- C) Mesatarja aritmetike
- D) Median

22.

Gjeni vlerën e shprehjes.

$$(-3^2) - (-3^2)$$

- A) 18
- B) 9
- C) -9
- D) 0

23.


Gjeni vlerën e shprehjes

$$(-1)^{2025} + 1^{2024} + (-1)^{2024}$$

- A) -2
- B) -1
- C) 0
- D) 1

24.

Një pishinë trekëndëshe kënddrejtë ndërtohet në një fushë që ka formën e një paralelogrami. Pjesa tjetër e fushës është e mbuluar me bar. Sa është sipërfaqja e mbuluar me bar?



- A) 440 m²
- B) 420 m²
- C) 400 m²
- D) 380 m²

25.

Gjej vlerën e shprehjes.

$$4^{-1} \cdot 8^{-2} \cdot 16^3$$

- A) -1
- B) 2^{-4}
- C) 2^4
- D) 2^{12}

26.

Hidhen dy zare. Gjeni probabilitetin që të dy zaret të tregojnë numrin 3.

- A) $\frac{1}{6}$
- B) $\frac{1}{12}$
- C) $\frac{1}{18}$
- D) $\frac{1}{36}$


27.

Gjej vlerën e shprehjes.

$$-3\sqrt{10} - 2\sqrt{10} - \sqrt{10}.$$

- A) $-6\sqrt{10}$
- B) $-5\sqrt{10}$
- C) $-4\sqrt{10}$
- D) $\sqrt{10}$

28.



Rendisni këndet e brendshme të trekëndëshit ABC më sipër në radhë, nga më i vogli te më i madhi.

- A) $A < B < C$
- B) $A < C < B$
- C) $C < B < A$
- D) $B < A < C$

29.

Cili është rregulli për një varg aritmetik me termin e parë 7 dhe diferencën 6?

- A) $6n-3$
- B) $5n+2$
- C) $6n+1$
- D) $6n^2 - 1$

30.

Cila është bashkësia e zgjidhjeve të mosbarazimit?

$$\frac{x+2}{3} \geq 1$$

- A) $x \geq 1$
- B) $x \geq -1$
- C) $x \leq 1$
- D) $x \leq -1$

31.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

 $\triangle \circ \square \triangle$
 $\circ \triangle \circ \square$
 $\square \triangle \circ \triangle$
 $\triangle \circ \triangle \square$
 $\Rightarrow \circ \triangle \circ \square = ?$

- A) 2141 B) 4142
C) 1421 D) 1412

32.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

$$\begin{array}{r} AA \\ AB \\ BA \\ + BB \\ \hline 330 \end{array} \Rightarrow A + B = ?$$

- A) 14 B) 15
C) 16 D) 17

33.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

 I. $5 \square 1025$

 II. $7 \square 1449$

 III. $9 \square 1881$

 Iv. $4 \square ?$

- A) 168 B) 618
C) 861 D) 816

34.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

 I. $5 \bullet 3 = \frac{8}{15}$

 II. $1 \bullet 2 = \frac{3}{2}$

 III. $2 \bullet 3 = \frac{5}{6}$

 Iv. $\frac{1}{2} \bullet \frac{1}{4} = ?$

- A) 3 B) 4
C) 5 D) 6

35.

Cilat numra duhen në vend të pikëpyetjes?

I. $5 \blacktriangle 2 = (3, 7, 10)$

II. $4 \blacktriangle 3 = (1, 7, 8)$

III. $2 \blacktriangle 1 = (1, 3, 4)$

IV. $3 \blacktriangle 1 = ?$

A) (2, 4, 6) B) (2, 4, 3)

C) (1, 2, 3) D) (3, 2, 6)

36.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

I. $\blacksquare 814 = 148$

II. $245 \blacktriangle = 265$

III. $\blacksquare 415 \blacktriangle = ?$

A) 145 B) 541

C) 214 D) 174

37.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

I. $2, 9 = 81$

II. $3, 4 = 64$

III. $2, 25 = 625$

IV. $3, 2 = 8$

V. $3, 5 = ?$

A) 255 B) 225

C) 125 D) 75

38.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

I. $\frac{\frac{1}{1}}{(a \square b)} = \frac{1}{a-b+2}$


II. $(14 \square 15) = ?$

A) 2 B) 1

C) 0 D) -1

39.


Gjej sipërfaqen



- A) 12 B) 13
C) 14 D) 15

40.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 3 B) 4
C) 5 D) 6

41.


Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

AKA
ILK
ILE $\Rightarrow$ ALI = ?
ALI

- A) 684 B) 685
C) 757 D) 786

42.


Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 48 B) 64
C) 72 D) 84

43.


Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 12 B) 24
C) 36 D) 48

44.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 338 B) 339
C) 340 D) 341

45.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

+	a	b	c
a		K	
b			
c	M	L	

$$\Rightarrow K - M = ?$$

- A) $a + c$ B) $a - b$
C) $b - c$ D) $b + c$

46.



Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

7	4	14
6	7	21
8	4	?

- A) 8 B) 10
C) 12 D) 16


47.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?





48.

Cila nga figurat është e ndryshme?




49.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



50.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 18 B) 20
C) 22 D) 24

51.

Ka si temë “*lojën luftash*” ndërmjet dy grupeve të djemve adoleshentë për të mbrojtur një fushë lojërash, romani:

- A) “Bota e Sofisë”
- B) “Djemtë e Rugës Pal”
- C) “Nata e Ustikës”
- D) “Dy botët”

52.

Kuptimi i figurshëm që krijohet në bazë të ngjashmërisë quhet:

- A) aliteracion
- B) metonimi
- C) epitët
- D) metaforë

53.

Pjesa “*Kush e solli Doruntinën*” i përket llojit të:

- A) legjendës
- B) tregimit
- C) novelës
- D) baladës

54.

Autori i poemës “*Kthimi i Odisesë*” është:

- A) Populli
- B) Homeri
- C) Uliksi
- D) Penelopa

55.

Nisin me një hyrje karakteristike, ku thërretet për frymëzim një hyjni e caktuar:

- A) Baladat legjendare
- B) Poemat epike
- C) Përrallat
- D) Mitet

56.

Në vargun “*Në mes të faqes i qesh hunda e hollë.*”, kemi figurën letrare të:

- A) Metonimisë dhe epitetit
- B) Metaforës dhe epitetit
- C) Similitudës dhe metaforës
- D) Krahimit dhe metaforës

57.

Romani “Poliana rritet” i përket llojit të romanit:

- A) shoqëror
- B) fantastiko – shkencor
- C) psikologjik
- D) filozofik

58.

“Nata e Ustikës” është shkruar nga:

- A) Mitrush Kuteli
- B) Petro Marko
- C) Musine Kokalari
- D) Ferenc Molnar

59.

Është një rast i rrallë, pasi është autobiografi e shkruar në vetën e tretë:

- A) Kujtimet
- B) “Kostandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut”
- C) “Prijësit shpirtërorë të Nolit të ri”
- D) “Tanusha e Laura”

60.

Nuk bëjnë pjesë në gjininë epike:

- A) epi, poema, epopeja
- B) lirika, poezia, soneti
- C) miti, përralla, fabula
- D) tregimi, novela, romani

61.

Qarkoni fjalinë që ka folje gjysmëndihmëse.

- A) Shpendët nisën të arratisen.
- B) Shpendët arratisen në vjeshtë.
- C) Shpendët filluan arratisjen.
- D) Shpendët janë arratisur këtë vit.

62.

Në fjalinë “Kishte shpërthyer pranvera me gjithë fuqinë e saj.” kallëzuesi është:

- A) Kallëzues foljor i thjeshtë
- B) Kallëzues foljor i përbërë
- C) Kallëzues emëror
- D) Kallëzues homogjenë

63.

Pjesëza “u” është e formës joveprore, koha e e tashme, mënyra dëshirore:

- A) Po u kërkoja shokëve që të vinin dhe ata me ne.
- B) U habita nga ajo çka dëgjova.
- C) U rritsh me nënë e babë!
- D) U bëka puna dhe kështu!

64.

Në cilën fjali, fjala e nënvizuar është lidhëz nënrenditëse ffilluese:

- A) **Që** të gjithë po të prisnin ty.
- B) E dija **që** ti do të vije me mua.
- C) Babai ishte i lumtur **që** djali ishte fëmijë i mbarë.
- D) Ai ndjek udhën e tij **që** e kanë hapur të tjerët.

65.

Gjeni alternativën që ka përcaktor me drejtim:

- A) Ç’plane ke për fundjavën tjetër?
- B) Kjo është fjalë me vend.
- C) Dëshira për të lexuar e pushtoi në moment.
- D) Në sytë e lodhur, i ndriti një flakë e lehtë gëzimplotë.

66.

Gjenden gjithmonë me folje në formën veprore:

- A) Kundrinori i drejtë
- B) Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë
- C) Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë
- D) Përcaktori

67.

Është morfemë trajtëformuese:

- A) tema fjalëformuese
- B) rrënja e fjalës
- C) mbaresa
- D) parashtesa dhe prapashtesa

68.

Është shkruar gabim përemri pronor:

- A) shoku jonë
- B) shoqes sime
- C) shokun tim
- D) shoku ynë

69.

Në cilën prej alternativave kemi fjali fthilluese me pjesë të nënrenditur kryefjalore:

- A) Shpresohet se këto dokumente do të hedhin dritë mbi atë periudhë.
- B) Asnjëherë nuk e kupton se ku e ka gabimin.
- C) Fëmija u fut papritur në sallën ku rrinin të ftuarit.
- D) U afruan atje ku do të mbillnin pemën e parë.

70.

Fjala e nënvizuar është parafjalë në fjalinë:

- A) I erdhi **rreth** oborrit të shkollës.
- B) Vizatoi një **rreth** në tabelë.
- C) Thirri **rreth** tridhjetë veta në ditëlindje.
- D) **Rreth** oborrit të shkollës ishin mbledhur shumë nxënës.